

KONFERENCË KOMBËTARE

INTEGRIMI EVROPIAN DHE ANGAZHIMI QYTETAR PËR DEMOKRACINË LOKALE

RRJETI POP

5 MARS 2024



BULETIN INFORMATIV

NGA RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE - POP

Rrjeti POP falenderon të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e jashtëzakonshëm në suksesin e Konferencës "Integrimi Evropian dhe Angazhimi Qytetar për Demokracinë Lokale." Partneriteti me Rrjetin POP dhe projektin "Kontrata Sociale 2023" solli një shembull të suksesit në forcimin e demokracisë vendore dhe integritetit në nivel lokal kur të gjithë aktorët e interesit punojnë sëbashku. Ne si rrjet, e vlerësojmë shumë pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin në monitorimin e proceseve të vendimmarrjes, si dhe promovimin e debatit politik për interesin e qytetarëve, si një prej pikave kryesore në realizimin e qëllimeve të konferencës.

Në partneritet me Olof Palme International Centre dhe National Endowment for Democracy, ne do të vijojmë frymën e bashkëpunimit në rrugën drejt një qeverisje më të përgjegjshme dhe përfshirëse për të gjithë qytetarët. Falenderojmë përzemërsisht folësit tanë të nderuar dhe përfaqësuesit e institucioneve kombëtare, rajonale dhe evropiane për kontributin e tyre në sesionet dhe diskutimet e konferencës, duke ndihmuar në arritjen e një diskutimi të thellë dhe të frytshëm për avancimin e demokracisë vendore në Shqipëri. Faleminderit për partneritetin dhe përkushtimin tuaj të palodhur!

[Ndiqni Konferencën](#)

Në datë 05.03.2024 në orën 10:00 Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” në partneritet me anëtarët e Rrjetit “Përballja e Ofertave Politike” - POP, e me mbështetjen e Qeverisë Suedeze përmes Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy organizuan Konferencën Kombëtare “Integrimi Evropian dhe Angazhimi Qytetar për Demokracinë Lokale.” Ky aktivitet u organizua në kuadër të Projektit “Kontrata Sociale 2023: Forcimi i Angazhimit të Qytetarëve në Qeverisjen Vendore”

Qëllimi kryesor i konferencës ishte diskutimi mbi Avancimin e demokracisë vendore dhe integrimin evropian në Shqipëri, me fokus të veçantë në angazhimin qytetar dhe transparencën vendore dhe realizimin e Objektivit të pestë strategjik të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 (SNDQV 2020-2030): “Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritimit evropian në nivel vendor.”

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor, përfaqësi diplomatike, organizata të shoqërisë civile nga Shqipëria, Rajoni dhe Evropa si edhe agjenci të ndryshme që operojnë në Shqipëri për forcimin e demokracisë vendore.

OBJEKTIVAT E KONFERENCËS

- Përmirësimi i proceseve dhe praktikave demokratike në nivel lokal duke nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, transparencën dhe llogaridhënien në vendimmarrje.
- Përmirësimi i komunikimit dhe mekanizmave të shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve vendore dhe qytetarëve, duke promovuar transparencën, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive në proceset vendore të vendimmarrjes.
- Përafrimi i strukturave dhe praktikave të qeverisjes vendore me standardet dhe parimet evropiane, duke kontribuar në integrimin e përgjithshëm të vendit në Bashkimin Evropian.
- Sigurimi që proceset e decentralizimit dhe të qeverisjes vendore të jenë gjithëpërfshirëse dhe të merren parasysh nevojat e ndryshme të të gjithë anëtarëve të komunitetit, duke përfshirë grupet e marginalizuara, përfshirë promovimin e barazisë gjinore, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave.

Ky event mjaft i rëndësishëm për Rrjetin POP u hap nga znj. Mirela Arqimandriti, Drejtore Ekzekutive e Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim” dhe u përshëndet nga Znj. Romina Kuko – Zv. Ministre e Punëve të Brendshme, Kryetare e Këshillit Bashkiak Tiranë; Sh.T. Z. Niklas Ström, Ambasador i Suedisë në Shqipëri; Znj. Marie Augouy, Menaxhere Programi, Qeverisja Vendore dhe Zhvillimit Rajonal, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri; dhe nga Suedia online nga Z. Johan Schmidt, Menaxher i Programit Rajonal për Ballkanin Perëndimor, Olof Palme International Center.





ZNJ. MIRELA ARQIMANDRITI
DREJTORE EKZEKUTIVE
QENDRA "ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM"

Me shumë entuziazëm qëndroj sot para jush për të diskutuar nismën transformuese të ndërmarrë nga Rrjeti Përballja e Ofertave Politike - POP, përmes zbatimit të projektit "Kontrata Sociale 2023: Forcimi i Angazhimit të Qytetarëve në Pushtetin Vendor". Kjo përpjekje nuk është vetëm një projekt; është një angazhim për qytetarët e Shqipërisë, një zotim për të siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe nevojat e tyre të adresohen në proceset vendimmarrëse që formësojnë jetën e tyre.

Thelbi i demokracisë qëndron në pjesëmarrjen e qytetarëve të saj dhe pikërisht këtu Rrjeti POP luan një rol kryesor. Duke monitoruar proceset e vendimmarrjes dhe duke marrë pjesë aktive në avokim, ne po ndikojmë në agjendat politike për t'u përafuar me interesat më të mira të qytetarëve. Qëllimi ynë është të përmirësojmë debatin publik, të ofrojmë informacion që fuqizon qytetarët dhe të drejtojmë platformat për t'i dhënë përparësi nevojave dhe aspiratave të njerëzve të cilëve u shërbejnë.

Ky projekt, i mbështetur bujarisht nga, Qeveria Suedeze, Qendra Ndërkombëtare Olof Palme dhe National Endowment for Democracy, shtrihet në dhjetë bashki: Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë dhe Pukë. Secila prej këtyre bashkive përfaqëson një strukturë unike të shoqërisë shqiptare dhe përpjekjet tona janë të përshtatura për të siguruar që çdo qytetar në këto rajone të ndihet i përfaqësuar dhe i dëgjuar. Objektivi kryesor i POP është të pasurojë diskursin publik dhe të ofrojë njohuri mbi agjendat zgjedhore të partive politike dhe kandidatëve për kryetar bashkie, me fokus të madh në adresimin e nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve tanë.

Në zemër të rrjetit POP qëndron Kontrata Sociale, një mjet i krijuar përpara zgjedhjeve vendore përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me njerëzit dhe kandidatet për kryetar bashkie. Ky proces përfshin realizimin e një sërë takimesh dhe hulumtimeve për të përcaktuar prioritetet e qytetarëve tanë. Më pas, mbledhen Forumet Publike, duke ofruar një platformë të drejtë dhe të hapur për përfaqësuesit e partive politike që të prezantojnë platformat e tyre dhe të angazhohen në dialog konstruktiv për kontratat sociale dhe shqetësimet e qytetarëve. Pikërisht këtu u jepet mundësia kandidatëve të zotohen për të adresuar prioritetet e qytetarëve gjatë katër viteve në vijim, duke nënshkruar Kontratën Sociale, nëse ata dalin fitues në zgjedhje.

Ne jemi veçanërisht të fokusuar në rritjen e angazhimit qytetar, sigurimin e transparencës lokale dhe monitorimin e zbatimit të Kontratës Sociale, përfshirë monitorimin e veprimeve të Këshillit Bashkiak dhe aspekte të tjera që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale. Rrjeti mbetet aktiv në përpjekjet lobuese dhe avokuese që synojnë nxitjen e transparencës dhe forcimin e demokracisë lokale. Gjithashtu monitorimi i zbatimit të objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 (SNDQV 2020-2030), është një nga synimet e rrjetit të organizatave POP.

Për të arritur këto synime, është thelbësore të theksohet roli kryesor i demokracisë lokale si një gur themeli për nxitjen e progresit të gjithanshëm demokratik. Kjo përfshin sigurimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivelin bazë. Integriteti duhet theksuar si një vlerë themelore për BE-në, duke siguruar besim, llogaridhënie dhe transparencë në qeverisje. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të luftuar korrupsionin dhe për të promovuar sjelljen etike si në administratën qendrore ashtu edhe në atë lokale. Është thelbësore të kultivohet një kulturë integriteti dhe llogaridhënieje brenda administratës publike.

Si përfundim, puna e Rrjetit POP dhe zbatimi i Kontratave Sociale shërbejnë si modele shembullore për rritjen e demokracisë lokale dhe nxitjen e angazhimit qytetar. Duke vazhduar përpjekjet tona të përbashkëta, ne mund të sigurojmë një të ardhme më të ndritshme, më transparente dhe të përgjegjshme për Shqipërinë, në përputhje me aspiratat tona për integrim evropian.



**ZNJ. ROMINA KUKO – ZV. MINISTRE E PUNËVE
TË BRENDSHME, KRYETARE E KËSHILLIT
BASHKIAK TIRANË**

“Me rrjetin POP kemi disa vite që bashkëpunojmë për Kontratën Sociale, në fillim nuk e fsheh që një pjesë nga ne ngrinte pikëpyetje, çfarë janë këto debate që behen kur ne kemi fushatë zgjedhore. Megjithatë, demokracia vendore në thelb ka atë që quhet përfshirje dhe ajo është një ekskluzivitet që i takon vetëm qytetarëve. Mendoj se POP është një mekanizëm shumë i rëndësishëm dhe është shumë e rëndësishme që ju bëni përditësim sesa janë të përmbushura objektiva.” - tha znj. Kuko.

Ndër të tjera znj. Kuko iu drejtua te rinjve për të inkurajuar angazhimin e tyre në procesin politik dhe në zhvillimin e demokracisë në nivel lokal. Ajo theksoi se të rinjtë duhet të marrin pjesë aktive në komunitetin e tyre duke u përfshirë në zgjedhjet për këshillat bashkiakë. Kjo përvojë jo vetëm që do t'u japë njohuri të reja dhe aftësi për të menaxhuar punët e bashkisë, por gjithashtu do të ndihmojë në ndërtimin e një shoqërie më të përfshirë dhe të drejtë. Iniciativa për ngritjen e komisioneve të integritimit në nivelin bashkiak u shpaloj si një hap i rëndësishëm drejt qeverisjes më të hapur dhe transparente.

Zonja Kuko shprehu bindjen se përfshirja e të rinjve në këto komisione do të sjellë një frymë të re në politikën lokale, duke e bërë atë më të përputhshme me nevojat dhe interesat e brezit të ri. Ajo theksoi se është e rëndësishme që të rinjtë të kenë mundësinë të shohin demokracinë në veprim dhe të ndjekin zhvillimin e politikave që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. *“Kjo pjesëmarrje aktive, - tha Zonja Kuka, është thelbi i qeverisjes demokratike dhe mund të çojë në një shoqëri më të përfshirë dhe të drejtë për të gjithë qytetarët.”*



**SH.T.Z. NIKLAS STRÖM
AMBASADOR
AMBASADA E SUEDISË NË SHQIPËRI**

Sh.T.Z. Ambasador e nisi fjalën e tij duke përshkruar Suedinë nga ana gjeografike dhe demokratike dhe jo pa qëllim. Duke qenë një vend me një shtrirje shumë të gjatë megjithëse me 10 milionë banorë, qeverisja dhe zbatimi i një demokracie funksionale në vend megjithëse e vështirë ka rezultuar e suksesshme, kjo me anë të decentralizimit brenda qeverisjes suedeze. Koncepti “E drejta e bashkive për vetëqeverisje” megjithëse ka limitet e veta, është shumë i gjerë në burimet që kanë bashkitë të cilat janë shumë të konsiderueshme. Siç psh. shkollat, infrastruktura dhe banesat janë të gjitha përgjegjësi e bashkive dhe 70% e të gjitha burimeve publike shpenzohen nga bashkitë. Dhe ndërsa ka nevojë për një sistem të decentralizuar në Suedi për shkak të madhësisë së vendit, të kesh një demokraci të fortë lokale është gjithashtu e dobishme për vendet më të vogla si Shqipëria. Duke vijuar z. Ambasador tha: *“Kjo është arsyeja pse unë jam krenar që Suedia, përmes mbështetjes sonë për Qendrën Olof Palme, po kontribuon në nxitjen e praktikave demokratike këtu. Demokracia është sigurisht edhe një gur themeli i procesit të integritimit në BE.”* Gjithashtu z. Ambasador theksoi edhe besimin si një prej gjërave më të rëndësishme në qeverisje, i cili është i vështirë për t'u fituar dhe shumë i lehtë për t'u humbur. Dhe, për të fituar besimin e qytetarëve përveç shumë faktorëve, u theksuan dy si më të rëndësishmit: transparenca dhe angazhimi i qytetarëve. Dy aspekte këto shumë të ndërlikdhura dhe lehtësisht të arritshme në një sistem të decentralizuar. *“Dua të shpreh bindjen time se angazhimi lokal mund të luajë një rol jetik në përmirësimin e procedurave demokratike si dhe në rritjen e besimit të publikut për ato procedura këtu në Shqipëri. Kjo, edhe një herë, është e dobishme për një proces të suksesshëm të integritimit në BE, në të cilin shumica e zbatimit do të duhet të bëhet në nivel lokal. Është jetike të marrësh pjesë dhe të inkurajosh procedurat demokratike lokale. Inkurajoj të gjithë aktorët dhe qeverinë në Shqipëri, që në mënyrë aktive të priorizojnë këtë temë. Demokracia lokale nuk duhet të jetë vezulluese, por duhet të jetë e aksesueshme. Disa karrige dhe kafe mund të jenë të mjaftueshme.”* – e mbylli fjalën e tij ambasadori i nderuar i Suedisë në Shqipëri.



ZNJ. MARIE AUGOUY – DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI

“Roli dhe angazhimi i shoqërisë civile janë një nga shtyllat e funksionimit të demokracisë”, u shpreh e nderuara zonja Augouy, duke shtuar se ky angazhim duhet të jetë në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe në vazhdimësi në nivel lokal pasi është më afër qytetarëve. Sipas Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, e cila u ratifikua nga Shqipëria në vitin 2020, pushteti vendor “është një nga themelet kryesore të çdo regjimi demokratik” dhe pjesëmarrja e qytetarëve në punët publike është një nga ato parime demokratike. Roli dhe angazhimi i qytetarëve për të marrë pjesë aktive në përcaktimin e agjendës politike dhe proceset e politikëbërjes janë thelbësore. Pushtetet lokale duhet të krijojnë kushte të favorshme për të forcuar dialogun me komunitetet të cilave u shërbejnë. Duke theksuar se në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimi Evropian, të dyja palët, shoqëria civile dhe qeveritë vendore, kanë një rol shumë të rëndësishëm në përmbushjen e kushteve për anëtarësim evropian. Znj. Augouy informoi gjithashtu se Bashkimi Evropian në Shqipëri mbështet krijimin e një mjedisi të favorshëm për një dialog të strukturuar dhe një bashkëpunim të fortë midis shoqërisë civile dhe pushtetit vendor. Ndër projektet e tjera të zbatuara nga BE, janë në zbatim 48 projekte të financuara nga Programi Evropa për Qytetarët për përfituesit shqiptarë, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, akademinë dhe bashkitë, nga të cilat 11 zbatohen nga bashkitë. Kjo, pa përmendur projektet emblematiche të financuara nga BE-ja si Bashki për Evropën, BE-ja për Bashkitë dhe Reload 2 që ofrojnë mbështetje për bashkitë për t’u angazhuar më shumë dhe më mirë me qytetarët dhe shoqërinë civile. Vlen gjithashtu të theksohet se aktualisht është duke u përgatitur një projekt prej 10 milionë eurosh me Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencinë për t’u dhënë bashkive më shumë mundësi për të investuar me qytetarët, për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet duke krijuar më shumë mundësi për komunitetet e tyre. Në përfundim, znj. Augouy përmendi rëndësinë e krijimit të kushteve për zbatimin e parimit të Partneritetit të BE-së që është në qendër të politikës së kohezionit të BE-së. “Për të përmbushur parimet e partneritetit të BE-së, autoritetet publike (kombëtare, rajonale dhe lokale) duhet të jenë në gjendje të angazhohen fuqishëm me komunitetet dhe grupet e tjera shoqërore dhe BE-ja është e gatshme për ti mbështetur këto përpjekje. Kjo konferencë është një mundësi e përkryer për të shkëmbyer mënyrat e nxitjes së partneritetit midis këshillave bashkiakë, administratës lokale, shoqatave të bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile.”



Z. JOHAN SCHMIDT - OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER

“Në çdo vend demokratik është një institucion që organizon debate politike përpara zgjedhjeve, në disa vende është një shërbim publik, media, universitetet, etj. Për ne në Palme Center, POP ka qenë një eksperiment, një përpjekje për të ndërtuar një platformë të tillë për qytetarët që të marrin pjesë në këto debate para zgjedhjeve.” - kështu e nisi fjalën z. Schmidt.

POP në vitet e fundit ka treguar se në qeverisjen vendore apo në atë qendrore është një institucion i tillë. Dhe ftesa është gjithmonë për të gjithë kandidatët dhe të gjitha partitë politike dhe megjithëse ka patur parti të një krahu politik që nuk kanë pranuar të marrin pjesë në përballje, POP ka organizuar debate në mënyrë të pavarur dhe individuale me secilin prej tyre në përballje me qytetarët. Zgjedhjet zhvillohen për ti shërbyer interesit të qytetarëve, jo partive politike dhe kandidatëve dhe POP ka treguar se kjo është e mundur, megjithë presionin politik, por me një bindje të fortë. POP gjithashtu ka ndërmarrë një hap tjetër në procesin demokratik, që është po aq i rëndësishëm, siç është monitorimi pas zgjedhjeve për përmbushjen e premtimeve të bëra nga kandidatët dhe partitë politike gjatë fushatave zgjedhore. Kjo është bërë me anë të një kontrate sociale sipas prioriteteve të qytetarëve.

“Ne kemi parë se gjatë viteve, rrjeti i organizatave që përfaqësojnë POP kanë mundur të zhvillojnë metodologjitë për të dyja pjesët: organizimi i debateve dhe monitorimi i premtimeve të bëra. Ne jemi shumë krenarë që jemi pjesë e këtij procesi, i cili është sfidues dhe duhet të përshtatet vazhdimisht me kushtet politike të reja. Mendoj se POP ka treguar pjekuri në trajtimin e këtyre çështjeve dhe ka dhënë një kontribut të madh në maturinë politike në Shqipëri. Ne vazhdojmë të mbështesim POP” - përfundoi fjalën e tij z. Johan Schmidt.

Sesioni 1: Forcimi i demokracisë vendore nëpërmjet sigurimit të një qasje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivel vendor.

Në këtë sesion, u diskutua mbi nismat për krijimin e një mjedisi ku mirëqeverisja dhe pjesëmarrja e qytetarëve janë thelbësore, si transparenca, angazhimi qytetar në vendimmarrje, konsolidimi i integritetit në nivel lokal dhe avancimin e axhendës së integritetit evropian. Diskutimi u përqendrua në sfidat dhe mundësitë e këtij rrugëtimi, duke vënë theksin në masat specifike që synojnë fuqizimin e demokracisë vendore dhe krijimin e një lidhje të ngushtë me qytetarët, si edhe rëndësia e Kontratës Sociale që realizoi rrjeti POP për angazhimin qytetar dhe llogaridhënien.

Ky sesion u moderua nga Znj. Adelina Farrici – Drejtoreshë Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore dhe solli diskutime nga: Z. Ferit Ringaj, Nënkryetar i Bashkisë Pukë; Znj. Keti Luarasi, Nënkryetare, Bashkia Tiranë; Z. Klevis Kaso, NënKryetar i Bashkisë Vlorë; Z. Ermal Elezi - Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore; Znj. Esmeralda Hoxha; Koordinatore e Rrjetit Përballja e Ofertave Politike, GADC.



**Z. FERIT RINGAJ - NËNKRYETAR
BASHKIA PUKË**

Fokusi kryesor i administratës së bashkisë Pukë është rritja e cilësisë së shërbimeve të qytetarëve përmes politkave konkrete duke filluar me buxhetin e bashkisë që është hallka kryesore, ku qytetarët kanë mundësinë që të jenë pjesë e diskutimeve për detajimin e tyre, po ashtu edhe diskutimi në komunitetet përkatëse sipas njësive administrative për të nxjerrë në pah të gjitha prioritetet e qytetarëve. Natyrisht me rrjetin POP janë bërë një seri aktivitete, me fokus tek dëgjesat publike dhe përfshirja e qytetarëve. Puka, si një zonë malore dhe me një numër të lartë të popullsisë që jeton në zonat rurale ka specifika të veçanta, të cilat janë shumë thelbësore, kryesisht ato të aspektit social dhe ekonomik. Përfshirjen qytetare, si të ardhur në drejtimin e bashkisë pas zgjedhjeve të majit 2023, e kemi fokusuar pikërisht tek takimet, dëgjesat dhe transparenca sa i përket buxhetimit në ato aspekte për të cilat më së shumti kanë nevojë qytetarët e Pukës. Kontrata Sociale e nënshkruar mes kryetarit të bashkisë Pukë dhe Rrjetit POP, është një prej dokumentave e cila do të shoqërohet me llogaridhënie, megjithatë duhet theksuar se ka shumë punë për të bërë.

Por, e rëndësishme është që pjesa e integritetit evropian, si një sfidë që ka shoqëria shqiptare është bërë pjesë e paneleve të diskutimit në nivel lokal në Pukë. Ka punë për të bërë për rritjen e kapaciteteve të administratës lokale për shërbimin ndaj qytetarëve dhe ne po përpiqemi të përmirësojmë strategjinë e shërbimeve. Për ta përmbyllur z. Ringaj shtoi: *“Ne po punojmë shumë për përfshirjen qytetare në vendimmarrje, sidomos rinia, duke qenë se kemi një bashkëpunim mjaft të mirë me Levizjen Rinore të rrjetit POP e cila po bën një punë të shkëlqyer në aktivizimin dhe në forcimin e të rinjve për llogaridhënien lokale. Dua të them që është bërë punë, ka nevojë për më shumë punë por edhe për mbështetje qoftë nga shoqatat, donatorë e më gjerë, për organizim aktivitete të tilla si sot, për tu azhornuar sipas specifikave apo dhe shembujve konkretë për integrimin e vendit në bashkimin evropian.”*



**"Integrimi Evropian dhe Angazhimi Qytetar
për Demokracinë Lokale."**



**Z. KLEVIS KASO - NËNKRYETAR
BASHKIA VLORË**

Bashkia Vlorë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të lidhjes me qytetarët nëpërmjet procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje. Përmes organizimit të dëgjësave publike në muajin tetor, të cilat u mbajtën në çdo rajon dhe njësi administrative të qytetit, qytetarët u ftuan të japin kontributin e tyre për të identifikuar prioritetet e tyre për buxhetin e vitit 2024. Kjo sipas z. Kaso tregon një angazhim të vërtetë për të dëgjuar zërin e qytetarëve dhe për të reflektuar nevojat e tyre në politikat buxhetore. Bashkëpunimi me aktorët e interesit dhe publikimi i vendimeve të rëndësishme në faqen e internetit për qytetarët shënojnë një hap drejt transparencës dhe informimit të plotë të tyre. Gjithashtu, hapja e zyrës së ndalesave për informim dhe shërbime të integruara ofron një platformë shtesë për qytetarët për të marrë informacion dhe për të shprehur nevojat e tyre në një mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efektive. *“Këto masa tregojnë përkushtimin e Bashkisë Vlorë për të përmirësuar dialogun dhe bashkëpunimin me qytetarët për të siguruar shërbime sa më cilësore dhe për të përmirësuar demokracinë vendore.”* - e mbylli fjalën e tij z. Kaso.



**ZNJ. KETI LUARASI - NËNKRYETARE
BASHKIA TIRANË**

Në bashkinë e Tiranës e kemi patur shumë për bazë fjalën e shoqërisë civile dhe jemi përpjekur maksimalisht për ta përfshirë edhe qytetarin në proceset vendimmarrëse të institucionit. Do të përmend vetëm 2 – 3 elemente: Përballja e Ofertave Politike është njëri nga elementët, ne kemi punuar me Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim” për disa vite me rradhë dhe kemi bërë edhe pjesën e raportimit të përmbushjes së Kontratës Sociale, një element ky shumë i mirë për pjesën se sa kemi realizuar arritjen e objektivave që i kemi të vendosura në planet tona të veprimit.

Një tjetër element përveç Buxhetimit me Pjesëmarrje që tashmë është zhvilluar suksesshëm, është ajo që bashkia Tiranë ka ndërmarrë për zhvillimin e programit të qendrueshëm strategjik 5 vjeçar të cilin e kemi filluar në vitin 2023 dhe tani në këtë moment jemi në përgatitjen përfundimtare për ta paraqitur planin strategjik para Këshillit Bashkiak për të marrë aprovimin përfundimtar.

Kjo strategji është draftuar me konsultim publik me qytetarët dhe shoqërinë civile me mbështetjen e ekspertëve nga Këshilli i Evropës, nga Strasburgu dhe Shqipëria. Gjithçka është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Tiranë në një sektor të veçantë sa i përket konsultimit për këtë strategji. Proces ky i kaluar në katër faza. Përveç kësaj kishim edhe një formë (jo vetëm online) për votimin nga qytetarët të pesë objektivave kryesore të kësaj strategjie. Mbi 150 qytetarë të Tiranës na u bashkuan në një takim të përbashkët dhe votuan me një aplikacion të thjeshtë online, për renditjen e objektivave sipas rëndësisë së tyre por edhe a ishin dakort mbi këto objektiva të paraqitura nga bashkia e Tiranës e cila do të punojë për 5 vitet e ardhshme.

“Në bashkinë Tiranë, pjesa e zgjerimit dhe hapja e proceseve vendimmarrëse është shumë e rëndësishme dhe përdorimi i një metodologjie siç përmendur më sipër na ka rezultuar shumë i suksesshëm.” - e përmbylli fjalën e saj znj. Luarasi duke mbetur e hapur për pyetje dhe diskutime në vijim.



**“Integrimi Evropian dhe Angazhimi Qytetar
për Demokracinë Lokale.”**



Z.ERMAL ELEZI - DREJTOR I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

“Agjencia si zbatuese e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore parashikon rritjen e rolit të këshillave bashkiakë si përfaqësues pranë organeve vendimmarrëse pa lënë mënjanë edhe kryetarët.” - tha z. Ermal Elezi

Ai shtoi se në muajt e fundit agjencia ka punuar intensivisht me Këshillat Bashkiakë, duke theksuar se për të kërkuar llogari, është e nevojshme të rriten kapacitetet lidhur me proceset vendimmarrëse, njohjen e ligjeve dhe aftësitë e mbikqyrjes së zbatimit të vendimeve. Përmes projektit "Bashki të Forta", janë trajnuar mbi 1000 anëtarë të këshillave bashkiak, duke ofruar module për të zhvilluar rolin e tyre në transparencë dhe llogaridhënie. Po ashtu, po punohet me Bashkitë për Evropën për të përfaqësuar interesat e proceseve të integritimit evropian në nivel të këshillave bashkiakë. Ndërkaq, një aspekt tjetër është rritja e performancës së administratës lokale dhe kryetarëve të bashkive, veçanërisht të përzgjedhurit e rinj, përmes trajnimeve të mbështetura nga Këshilli i Evropës. *“E rëndësishme është të vlerësohet se sa performojnë bashkitë, duke u bazuar në numrin e punonjësve në administratën publike lokale dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.”* -shtoi z. Elezi. Për të përmbushur standardet e performancës, ka filluar një proces performancash në të gjitha 61 bashkitë e vendit, duke përfshirë edhe analizën e funksioneve për të zbuluar arsyet e mosperformancës, duke përfshirë aspekte si llogaridhënia dhe transparenca por edhe përfaqësimi gjinor. Ky i fundit në nivel të këshillave bashkiakë është i kënaqshëm (40%) por në nivel kryetarësh bashkie është shumë më i ulët sesa parlamenti. Këta janë elementë si paketë e performancës se si duhet të përmirësohet administrata lokale në të ardhmen. Në vijim z. Elezi tha: *“Sa i përket procesit të përfshirjes qytetare, një prej roleve kryesore të shoqërisë civile duhet të jetë ky. Sado të përpiqemi ne si agjenci apo bashkitë, llogaridhënia është një proces që mund ti interesojë deri në një farë pike dhe shoqëria civile me formate të ndryshme duhet të shkojë pranë bashkive. Në lidhje me procesin e integritimit evropian, është e rëndësishme të vazhdohet përparimi, bazuar në objektivat që janë vendosur dhe të përpiqemi të përfaqësojmë me standartet evropiane për të përmirësuar shoqërinë”*



ZNJ. ESMERALDA HOXHA – KOORDINATORE E RRJETIT PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE, QENDRA ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM

Rrjeti Përballja e Ofertave Politike - POP është një nismë e rrjetit të 10 organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri dhe që zhvillojnë aktivitetin e tyre në: Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Kukës, Shkodër, Elbasan, Vaun e Dejës, Pukë dhe Korçë. Synimi i POP është të promovojë debatin publik dhe të sigurojë informacion për platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, duke i përqendruar ato në nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Përmes aktiviteteve të ndryshme, projekti synon të forcojë demokracinë në Shqipëri, duke inkurajuar transparencën dhe llogaridhënen gjatë zgjedhjeve dhe pas tyre. Rrjeti POP ka një histori të organizimit të nismave të ngjashme para, gjatë dhe pas zgjedhjeve në Shqipëri, duke përfshirë aktivitete të zhvilluara që nga viti 2013 dhe me një fokus të veçantë tek zgjedhjet vendore që prej vitit 2019, zgjedhjet vendore të pjesshme në 2022 dhe zgjedhjet e fundit të majit 2023. Një prej mekanizmave kryesorë që përdor rrjeti POP është **Kontrata Sociale**, një dokument i hartuar para zgjedhjeve vendore në bashkëpunim me qytetarët, përfshirë fokus grupet, intervistat gjysmë të strukturuar dhe hulumtimet, për të përcaktuar prioritetet kryesore të qytetarëve. Në vijim, organizohen Forumet Publike që synojnë të nxisin kulturën demokratike dhe të sigurojnë një hapësirë të hapur dhe të barabartë për përfaqësuesit e partive politike për të paraqitur platformat e tyre dhe për të diskutuar me qytetarët rreth Kontratave Sociale dhe shqetësimeve të tyre. Metodologjia e POP bën të mundur që në fund të këtyre takimeve, kandidatët të firmosin Kontratën Sociale, duke marrë përsipër kështu angazhimin për të adresuar prioritetet e qytetarëve në katër vitet e ardhshme në rast fitoreje të zgjedhjeve. Kontratata Sociale 2019-2023 u monitoruan nga organizatat lokale për katër vite, duke prodhuar raporte monitoruese vjetore për secilën nga 10 bashkitë ku operojnë, duke përfunduar kështu një cikël katër vjeçar me një adresim prej 74.5% të prioritetëve të qytetarëve. Në zgjedhjet e majit 2023, duke ndjekur metodologjinë e konsoliduar të POP, u hartuan Kontratata e reja Sociale 2023-2027 të cilat u prezantuan në 18 forume publike dhe u firmosën nga kandidatët të cilët morën angazhimin për adresimin e këtyre prioritetëve në katër vitet në vijim. *Ndërkohë, Rrjeti POP vazhdon punën monitoruese jo vetëm për bashkitë, por edhe për vendimet e Këshillit Bashkiak dhe aktivitete të tjera të lidhura me pushtetin vendor, duke lobuar dhe advokuar për transparencë dhe demokraci vendore.*

Sesioni 2: Promovimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor – perspektiva nga Shqipëria dhe Rajoni

Diskutimet në këtë sesion u përqendruan në progresin e Shqipërisë drejt integritit në Bashkimin Evropian (BE) dhe nevoja për përpjekje të vazhdueshme nga administrata qendrore dhe lokale. Në këtë kontekst, qëllimi kryesor është krijimi i një administrate publike të specializuar, jo-burokratike dhe transparente për të përshpejtuar avancimin e reformës së administratës publike në nivelin lokal. Në këtë sesion, panelistë nga vendi dhe rajoni ndanë praktikën e tyre për fuqizimin e kapaciteteve të administratës lokale për të përballuar sfidat e integritetit evropian.

Ky sesion u moderua nga znj. Esmeralda Hoxha – GADC dhe sollti diskutime nga: Z. Boran Ivanovski, Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS); Znj. Katica Janeva, Shoqata Evropiane për Demokracinë Lokale (ALDA); Znj. Megi Reçi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM); Znj. Elira Salihu, Democracy Plus, Republika e Kosovës dhe Z. Blendi Dibra, Intelktualët e Rinj Shpresë – Rrjeti POP.



**Z. BORAN IVANOVSKI - OFICER PROGRAMI
NALAS**

NALAS si një rrjet i shoqatave të autoriteteve lokale promovon bashkëpunimin e decentralizuar i cili ofron një mundësi për anëtarët tanë të mbështesin njëri-tjetrin, të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të kontribuojnë në procesin e decentralizimit dhe integritit në BE. Bashkitë kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e acquis/legjislacionit të BE-së, i cili krijon kornizën e standardeve të shërbimit, por në të njëjtën kohë kanë një rol për të luajtur në zbatimin e tyre duke modernizuar shërbimet publike. Në këtë kontekst, roli i shoqatave kombëtare të bashkive është jashtëzakonisht i rëndësishëm në procesin e integritit Evropian. Progres raporti i Komisionit Evropian luan një rol vendimtar në ofrimin e udhëzimeve të qarta për qeveritë vendore për të kontribuar në procesin e anëtarësisimit. NALAS përmes rrjetit të saj të shoqatave të autoriteteve vendore, për shembull, mbështet bashkitë në rritjen e kapaciteteve të tyre për të vlerësuar nevojat e grupeve vulnerabël duke aplikuar Metodologjinë e Hartëzimit Social “Të mos lëmë asnjë pas” (Leave No One Behind) dhe në këtë mënyrë për të menaxhuar shërbimet sociale të bazuara në nevoja.

Megjithëse ka një sërë programesh dhe projektsh të zhvillimit të BE-së dhe të tjera të disponueshme që mund të ofrojnë mbështetje të rëndësishme, kapacitetet absorbuese të qeverive vendore mbeten të kufizuara. Kjo vjen kryesisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore me aftësitë e nevojshme për zhvillimin e projekteve, por edhe të një rrjeti të kufizuar partnerësh potencialë, kur bëhet fjalë për projekte ndërkufitare dhe të tjera evropiane. Prandaj, NALAS-i mbështeti iniciativën e qytetit të Sarajevës për krijimin e një rrjeti të qytetit, i cili do të punojë në forcimin e ekipeve bashkiake të projektit në aksesin në fondet e BE-së dhe donatorëve të tjerë dhe të rrisë bazën e tyre të partneritetit të projektit, duke rezultuar në hartimin dhe dorëzimin e projekteve të përbashkëta për të mirën e qytetarëve.



**"Integritimi Evropian dhe Angazhimi Qytetar
për Demokracinë Lokale."**



**ZNJ. KATICA JANEVA - SHOQATA EVROPIANE
PËR DEMOKRACINË LOKALE (ALDA)**

Në ALDA, ne zbatojmë forma të ndryshme të angazhimit të qytetarëve në nivel lokal për tema dhe çështje të shumta. Pjesëmarrja dhe angazhimi i qytetarëve janë të nevojshme për t'iu përgjigjur shoqërive komplekse dhe të integruara. Pjesëmarrja është thelbësore për disa arsye:

E para është se sektori publik ka nevojë për më shumë burime. Provat tregojnë se nivelet bashkiake, rajonale ose nën-rajonale kanë nevojë për më shumë burime për detyrat e caktuara, edhe në kontekstin legjislativ të decentralizimit të lartë. Funkcionet e qyteteve dhe komuniteteve lokale janë gjithmonë më të rëndësishme se sa mund të kryejë sektori publik. Prandaj, ne kemi nevojë për më shumë burime që mund të gjenden në një partneritet të thellë dhe thelbësor me qytetarët dhe shoqërinë civile, të cilat mund të kontribuojnë me besim, kohë, lidhje, burime dhe angazhim.

Arsyeja e dytë është nevoja që punët dhe sektorët publikë të përshtaten me një transformim global kompleks dhe të shpejtë. Si në nivel shoqëror ashtu edhe në aspektin ekonomik, mandati i caktuar për organet politike lokale (zakonisht 4 ose 5 vjet) është shumë i gjatë për t'u angazhuar sërish në dialog vetëm përmes zgjedhjeve. Pra, dialogu duhet të zhvillohet vazhdimisht për ndryshimin e situatave dhe diskutimeve dhe skenarëve të rinj. Qytetarët kërkojnë më shumë pjesëmarrje dhe synime ambicioze; në shumicën e vendeve, ata kërkojnë të dëgjohen dhe të kenë një rol në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre.

Për ta përmbyllur "ALDA avokon për ngritjen e mekanizmave të fuqishëm kundër korrupsionit në nivel vendor. Ne besojmë se parandalimi i korrupsionit kërkon një qasje të shumëanshme, që përfshin reforma legjislative, masa mbrojtëse institucionale dhe mobilizim. Duke bashkëpunuar me aktorët përkatës, duke përfshirë agjencitë qeveritare, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, ne përipiqemi të krijojmë një mjedis ku korrupsioni nuk tolerohet dhe autorët do të mbahen përgjegjës." - tha zonja Janeva



**ZNJ. ELIRA SALIHU - DEMOCRACY PLUS
REPUBLIKA E KOSOVËS**

Siç edhe dihet, Republika e Kosovës aktualisht ka statusin e kandidatit potencial për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Si rrjedhojë, ka mjaft sfida në këtë rrugëtim prandaj kërkohet vëmendja jo vetëm e nivelit qendror por edhe atij lokal për shkak të rëndësisë që ka, rëndësi të cilën e nxjerr në pah edhe raporti i progresit. Sa i përket rolit të shoqërisë civile në këtë proces, kjo pasqyrohet edhe në raportin e fundit të progresit ku shoqëria civile përshkruhet si një partner i rëndësishëm në kuadër të përgatitjes së Kosovës për anëtarësim në BE dhe marrëdhënia e qeverisë me shoqërinë civile ka vend për përmirësim në bazë të disa rekomandimeve të paraqitura aty. Njëri prej qëllimeve të Demokraci Plus është që të përfshijë qytetarët në proceset e hartimit dhe zbatimit të politikave publike. Në kuadër të këtij qëllimi, trajtohen çështje të tilla si transparenca, llogaridhënia publike dhe konsultimi publik për të kontribuar në këto procese. Për të përmbushur këtë qëllim që proklamon një demokraci të shëndoshë në vend, D+ ka një numër të madh praktikash që kontribuojnë në përmbushjen e saj e që janë: Përkrahje dhe inkurajim në përdorimin e platformës digjitale të konsultimit publik si e-konsultimi ku qytetarët mund të shkruajnë komente/sygjerime për draft rregullorë e dokumente të ndryshme të rëndësishme që shplasohen aty, pastaj platforma "Ndreçe" e cila është një mundësi ideale për qytetarët për të raportuar çdo problem që ndërlihet me Komunën, bashkangjitur me foto dhe automatikisht këto kërkesa i përcillen zyrtarëve të caktuar nga marrëveshja që ne nënshkruajmë me Komunat. Në këtë mënyrë, kjo platformë rrit pjesëmarrjen publike dhe përgjegjësinë komunale për adresimin e kërkesave.

Gjithashtu, D+ vitin e kaluar ka kontribuar në organizimin e buxhetimit me pjesëmarrje në pesë komuna në të cilat është dalluar një rritje e numrit të pjesëmarrjes së qytetarëve krahasuar me dëgjimet apo konsultimet publike klasike që organizon Komuna pasi që si proces ka dëshmuar që sjellë transparençë dhe përgjegjshmëri në shpenzimet publike.

Të gjitha këto praktika kontribuojnë në rritjen e pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse në qeverisjen lokale, duke siguruar një qeveri më përfaqësuese dhe më të përgjegjshme.



ZNJ. MEGI REÇI - INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM (IDM)

Në përpjekjet për të forcuar integritetin, transparencën dhe llogaridhënien në qeverisjen vendore, një fokus i veçantë është në hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit. Këto plane janë dokumente strategjike anti-korrupsion në nivel institucioni, të cilat përfshijnë masa dhe veprime të shënuara nëpërmjet vlerësimit të rrezikut të integritetit. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) prej 2019 ka ofruar ndihmë në hartimin e këtyre planeve për 23 bashki të vendit në bashkëpunim me programet e OKB-së për zhvillim (UNDP). Përveç hartimit të dokumenteve, IDM ka ofruar edhe trajnime për forcimin e kapaciteteve administrative në fushën e etikës, integritetit, transparencës dhe llogaridhënies, duke përfshirë edhe hartimin e instrumenteve udhëzuese për këto procese.

Për të siguruar që këto përpjekje të jenë të qëndrueshme, IDM ka bashkëpunuar me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për të përfshirë module trajnimi në programet e tyre të vazhdueshme për punonjësit civilë. Përveç kësaj, IDM ka hartuar instrumente monitorimi, siç është Indeksi i Integritetit dhe kanë ofruar mbështetje për organizatat e shoqërisë civile për të monitoruar integritetin në nivel vendor.

Në këtë kontekst, një fokus i veçantë është në bashkëpunimin konstruktiv me organizatat e tjera të shoqërisë civile dhe institucionet vendore për të siguruar që monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të planeve të integritetit dhe reformave të tjera të qeverisjes vendore të jenë efektive dhe të mbrojnë interesin publik. Një qasje e përbashkët e bashkëpunimit dhe monitorimit lejon organizatat shoqërore të ruajnë rolin e tyre mbikëqyrës dhe të ndihmojnë në forcimin e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së institucioneve publike. Në përmbyllje znj. Reçi tha: “Për të mbrojtur integritetin tonë dhe për të mos humbur funksionin që kemi, mendoj se nevojitet një ekuilibër i shëndetshëm i bashkëpunimit konstruktiv me monitorimin, pa lejuar që njëra të kompromentojë tjetrën.”



Z. BLENDI DIBRA – INTELEKTUALËT E RINJ SHPRESË , SHKODËR - RRJETI POP

Si pjesë e rrjetit POP, kemi zhvilluar një model të ndërmjetësimit për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve dhe për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën e pushtetit vendor. Kjo është një përpjekje që ka vazhduar për disa vite dhe synon të formalizojë premtimet elektorale të përfaqësuesve politikë, të zgjedhurve vendorë dhe kryetarëve të bashkive nëpërmjet kontratës sociale. Kjo kontratë është një mjet që i angazhon ata për të përmbushur premtimet e tyre ndaj qytetarëve dhe për të adresuar problemet që janë ngritur nga komunitetet.

Qëllimi ynë është që kjo pjesëmarrje e qytetarëve dhe angazhimi i pushtetit lokal të mos jenë vetëm fushat elektorale, por të integrohen si një pjesë e rëndësishme e procesit të vendimmarrjes. Për këtë arsye, monitorojmë punën e Bashkive në mënyrë sistematike dhe bashkëpunojmë ngushtë me partnerët lokalë për të siguruar zbatimin efektiv të premtimit dhe për të adresuar çështjet që janë prioritet për komunitetin.

Në të njëjtën kohë, bazuar në rekomandimet e fundit të Progres Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, ne kemi identifikuar disa prioritet të veçanta të cilat duhet të adresohen në nivel vendor. Këto përfshijnë konsolidimin e shoqërisë civile në nivel lokal, pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes vendore dhe përmirësimin e transparencës së financave vendore. Po ashtu, kemi një fokus të veçantë në rritjen e kapaciteteve të punonjësve vendor në lidhje me çështjet e të drejtave të njeriut dhe përfaqësimin e grave në pushtetet vendor dhe pjesëmarrjen e tyre në mënyrë të plotë.

“Bashkëpunimi me shoqërinë civile është thelbësor, pasi synimi ynë nuk është të marrim pushtetin, por të përmirësojmë qeverisjen, duke u siguruar se ata do të garantojnë mandatin e tyre të ardhshëm.” - mbylli fjalën e tij z. Dibra.

Sesioni 3. Ndikimi i Këshillave Bashkiakë për përmbushjen e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030

Organet lokale të qeverisjes, të njohura si Këshillat Bashkiakë, mbajnë një përgjegjësi të konsiderueshme për zbatimin e strategjisë, duke siguruar që vendimet dhe politikat përputhen me kërkesat e komuniteteve lokale. Bashkëpunimi i tyre me autoritetet qendrore dhe vendore është jetik në nxitjen e një qasje gjithëpërfshirëse të qeverisjes dhe në forcimin e demokracisë lokale. Gjatë këtij sesioni, u diskutua mbi ndikimin e tyre në proceset e marrjes së vendimeve dhe zbatimin e reformave, duke mbështetur një qeverisje efektive dhe transparente në nivel lokal.

Ky sesion u moderua nga znj. Nevila Jahaj – Qendra “Epoka e Re” dhe solli diskutime nga: Znj. Romina Kuko – Kryetare e Këshillit Bashkiak Tiranë; Z. Fatlum Nurja – Bashki të Forta; Znj. Jolanda Trebicka, Bashki për Evropën dhe Znj. Alketa Lamani, Qendra Rinore e Vlorës – Rrjeti POP.



Z. FATLUM NURJA PROJEKTI BASHKI TË FORTA, HELVETAS

Në një mjedis ku vetëqeverisja vendore shpesh herë është shkundur nga fuqia e një kryetari bashkie apo administrate, lind pyetja se si mund të sigurohet që qytetarët të kenë një rol aktiv dhe të ndjehen të përfshirë në procesin vendimmarrës. Z. Nurja, ngriti këto shqetësime, duke kërkuar më shumë përgjegjësi dhe transparencë nga këshillat bashkiakë.

Ai theksoi rëndësinë e këshillave bashkiakë si organet kryesore të vetëqeverisjes vendore, siç parashikon Kushtetuta e Shqipërisë. Megjithatë, në praktikë, fuqia e tyre shpesh herë zbehet nga autoriteti i kryetarit të bashkisë. Problemi më i theksuar vjen nga mungesa e një ligji për referendumin, duke i lënë qytetarët pa një mekanizëm të qëndrueshëm për të shprehur mendimet e tyre në vendimmarrje.

Në të njëjtën kohë, përpjekjet për të sjellë ndryshime pozitive janë evidente. Bashkitë, duke u përpjekur të përputhen me ligjin për vetëqeverisjen vendore, kanë nisur të rregullojnë veten nëpërmjet rregullave dhe procedurave të miratuara nga vetë këshillat bashkiakë.

Në këtë drejtim, shumë prej tyre kanë miratuar rregullore për organizimin dhe funksionimin e tyre, duke përfshirë kode të etikës, rregulla për konsultimin e publikut, trajtimin e ankesave dhe peticioneve, si dhe strukturat komunitare, rregullore këto të ofruara nga projekti Bashki të Forta.

Ndër të tjera z. Nurja tha: *“Edhe pse ka përpjekje për të rritur transparencën, vetëm një pjesë e këshillave bashkiakë transmetojnë mbledhjet e tyre live. Gjithashtu, regjistrat elektronik për kërkesa dhe ankesa janë ende në një fazë fillestare, duke lënë hapësirë për përmirësime të mëtejshme.”*

Në thelb të këtyre përpjekjeve është ndryshimi i mentalitetit të të gjithë aktorëve të përfshirë. Si qytetarë dhe përfaqësuesi të vetëqeverisjes vendore, duhet të kuptojmë se demokracia lokale nuk është thjesht një proces, por një angazhim i vazhdueshëm për të siguruar përfshirjen e të gjithëve në vendimmarrje.

Në këtë rrugëtim drejt një demokracie më të fortë dhe më të përfshirë, përpjekjet e të gjithëve që punojnë për të njëjtën qëllim janë të domosdoshme dhe inkurajuese.





**ZNJ. JOLANDA TREBICKA
BASHKI PËR EUROPËN**

Në lidhje online, konferencës iu bashkua edhe znj. Jolanda Trebicka e cila solli një përmbledhje të programit "Bashki për Evropën". "Kur u ngritën dhe u konceptuan Njësitet e Integritimit, u ngritën me idenë që të luanin rolin e strukturave që vendet e Bashkimit Evropian kanë ngritur si "EU direct Office" dhe u mendua që nga tre zyrat e informimit që kishte BE-ja, të ngriheshin zyrat e informimit në të gjitha bashkitë e vendit, të cilat më pas u transformuan edhe në njësitet e integritimit Evropian, të cilat janë një ndërfaqe shumë e rëndësishme midis BE dhe nivelit vendor." - tha znj. Trebicka.

Sipas Progres Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2023, nxori një konkluzion shumë të rëndësishëm në lidhje me forcimin që Rrjeti i koordinatorëve të integritimit në BE (Njësitet e Integritimit Evropian në bashki) në bashki ka realizuar në përfshirjen e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në procesin e anëtarësimit në BE. Të ngritura që në vitin 2017, megjithëse ka patur problematika dhe sfida, ka patur edhe qëndrueshmëri dhe rezultate, kjo është vënë re edhe në kapacitetet e bashkive për të përthithur fondet e Bashkimit Evropian, me rreth 40 milion EUR vetëm gjatë periudhës 2021-2022. Sidoqoftë, angazhimi i organeve të zgjedhura të pushtetit lokal dhe administratës vendore në procesin e integritimit në BE duhet të forcohet, veçanërisht në kontekstin e negociatave për anëtarësim në BE.

Qeverisja vendore ka një rol shumë të madh në procesin e negociatave, sepse nga 33 kapituj në 23 prej tyre NJQV luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e Acquis. Më përpara bashkitë shikoheshin si aktorë në këtë proces, por BE i jep një rëndësi shumë të madhe qeverisjes në shumë nivele për proceset e integritimit, për zbatimin e legjislacionit evropian që më përpara nuk kuptohej. Por, me punën që është bërë nëpërmjet projektit, ka arritur të ketë një ndërgjegjësim gjithnjë e më të madh dhe së fundmi dhe së fundmi po bashkëpunojmë edhe me zyrën e kryenegociatorit për rritjen e kapaciteteve brenda bashkive.



**ZNJ. ALKETA LAMANI - QENDRA RINORE E
VLORËS, RRJETI POP**

Znj. Lamani shprehu nevojën për një përqëndrim të thellë në implementimin e Strategjisë së Decentralizimit, duke identifikuar disa sfida dhe synime për të ardhmen e qeverisjes vendore. Ajo theksoi se për arritjen e këtij suksesi, është e rëndësishme që të ketë angazhim të shtuar nga stafet vendore dhe këshillat bashkiakë. "Kjo nuk është thjesht një detyrë teknike, por një përkushtim për të përmbushur objektivat e caktuara në fushën e qeverisjes lokale dhe demokracisë." - tha znj. Lamani.

Zonja Lamani vuri në dukje se objektivat e Strategjisë së Decentralizimit përfshijnë përmirësimin e proceseve dhe praktikave demokratike në nivel lokal, duke nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, si dhe garantimin e transparencës dhe llogaridhënies në këto procese. Kjo kërkon një komunikim të hapur dhe të qëndrueshëm me qytetarët dhe përmirësimin e mekanizmave të shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve vendore dhe komunitetit.

Përveç kësaj, është e domosdoshme për qeverisjen vendore të përputhet me standardet dhe parimet evropiane, duke kontribuar kështu në integrimin e përgjithshëm të vendit në Bashkimin Evropian. Ky proces është një ndërmarrje që kërkon ndërgjegjësim dhe përkushtim të vazhdueshëm për të përmirësuar strukturat dhe praktikën e qeverisjes lokale.

Për më tepër, Znj. Lamani thekson se një qeverisje vendore e suksesshme duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të konsiderojë nevojat e të gjithë anëtarëve të komunitetit, duke përfshirë grupet e marginalizuara dhe duke promovuar barazinë gjinore, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Kjo përfshirje e gjerë dhe kujdesi ndaj diversitetit është korniza që do të ndihmojë në ndërtimin e një demokracie lokale aktive dhe të qëndrueshme në të ardhmen.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME NGA KONFERENCA

- Përdorimi i mekanizmave si Kontratave Sociale mund të rrisin angazhimin e qytetarëve në proceset vendimmarrëse lokale.
- Përmirësimi i demokracisë lokale përmes ndërveprimeve me qytetarët dhe përfshirjes së tyre në debatin publik është jetik për rritjen e demokracisë në nivel lokal.
- Monitorimi i zbatimit të Kontratave Sociale POP dhe strategjive të qeverisjes vendore është i rëndësishëm për të siguruar që nevojat e qytetarëve adresohen efektivisht.
- Përfshirja e qytetarëve në procesin politik lokal, përmes mekanizmave si rrjeti POP, është një hap i rëndësishëm drejt një politike më të përputhur me nevojat dhe interesat e komunitetit.
- Inkurajimi i pjesëmarrjes së rinisë në zgjedhjet lokale dhe në komisionet e integritetit është një hap i rëndësishëm drejt një demokracie më të fortë dhe më përfaqësuese.
- Investimi në transparencë dhe angazhimin e qytetarëve në proceset vendimmarrëse është thelbësor për forcimin e demokracisë lokale.
- Roli dhe angazhimi i shoqërisë civile janë thelbësorë për funksionimin e demokracisë lokale dhe dialogu i strukturuar dhe bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe pushtetit vendor duhet të përmirësohet për të siguruar pjesëmarrje të gjerë dhe të ndërgjegjshme të qytetarëve.
- Pushtetet vendore duhet të krijojnë kushte të favorshme për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse përmes investimeve në infrastrukturë dhe shërbime lokale.
- Investimi në metodologjitë për organizimin e debateve politike dhe monitorimin e premtimeve të bëra nga kandidatët dhe partitë politike mund të forcojë transparencën dhe llogaridhënien në proceset zgjedhore.
- Krijimi i mjedisit të nevojshëm për diskutim të lirë dhe monitorim të qeverisjes do të ndihmojë në zhvillimin e një shoqërie më demokratike dhe të përgjegjshme.
- Vazhdimi i përpjekjeve për të forcuar pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, duke përfshirë rininë dhe komunitetet rurale, është jetik për përfaqësimin dhe mbështetjen e nevojave të të gjithë komuniteteve.
- Organizimi i dëgjësive publike dhe konsultimeve me qytetarët duhet të vazhdojë për të përcaktuar dhe reflektuar prioritetet e qytetarëve në politikat dhe buxhetin lokal.
- Investimi në platforma dhe shërbime të integruara që ofrojnë mundësi për qytetarët për të marrë informacion dhe për të shprehur nevojat e tyre në një mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efektive është shumë i rëndësishëm.
- Përdorimi i metodologjive të hapura për hartimin e politikave dhe strategjive bashkiake, duke përfshirë konsultimet publike dhe vlerësimin e nevojave të qytetarëve, është një përparim i rëndësishëm drejt demokracisë lokale.
- Trajnimi dhe përkrahja e këshillave bashkiakë për të rritur njohuritë e tyre lidhur me ligjet dhe proceset vendimmarrëse, si dhe për të thelluar angazhimin e tyre në transparencë dhe llogaridhënie, është thelbësore.
- Adresimi i rekomandimeve të identifikuar nga Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë është jetik për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në BE.
- Nevoja për një ligj për referendumin është e rëndësishme për të siguruar një mekanizëm të qëndrueshëm për qytetarët për të shprehur mendimet e tyre në procesin vendimmarrës.
- Rritja e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse, duke siguruar transmetimin live të mbledhjeve të këshillave bashkiakë dhe duke zhvilluar regjistrat elektronik për kërkesa dhe ankesa, është e rëndësishme për të forcuar demokracinë lokale.
- Ndryshimi i mentalitetit të të gjithë aktorëve të përfshirë është thelbësor për të krijuar një kulturë të fortë të demokracisë lokale dhe për të siguruar pjesëmarrjen e të gjithëve në procesin vendimmarrës.
- Përputhshmëria me standardet evropiane dhe angazhimi në procesin e integritetit në BE janë kritike për përparimin e demokracisë lokale në Shqipëri.



RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE - POP

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy."

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës
- Qendra Rinore Vlorë
- Epoka e Re, Fier
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
- Qendra Rinore për Progres, Kukës
- Gruaja në Zhvillim, Korçë
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës
- Tjetër Vizion, Elbasan
- Intelktualët e Rinj Shpresë, Shkodër

KONTAKT

Adresa: Rr."Abdyl Frasheri", P.10/1, Tirana, Albania

Telefon: +355 (0) 422255514

Celular: +355 69 61 20 169

Email: perballjaeofertavepolitike@gmail.com

Web: <https://popnetwork.al/>

